



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE

Këshilli Drejtues

V E N D I M

Nr. 2500, datë 22. 09. 2014

Për

“Miratimin e dokumentit përfundimtar për “Kryerjen e studimit mbi pagesat që janë burim financimi në AKEP” dhe propozimeve për miratim në Këshillin e Ministrave””.

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), i përbërë nga:

1. Z. Piro	Xhixho	Kryetar
2. Z. Alban	Karapici	Anëtar
3. Znj Alketa	Mukavelati	Anëtare
4. Z. Benon	Paloka	Anëtar
5. Znj. Zamira	Nurçe	Anëtare

dhe sekretare Znj. _____, në mbledhjen e datës _____.____.2014, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918, datë 19.05.2008, “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjin nr. 8480, datë 27.05.1999, “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”, shqyrtoi çështjen me objekt:

“Miratimin e dokumentit përfundimtar për “Kryerjen e studimit mbi pagesat që janë burim financimi ne AKEP” dhe propozimeve për miratim në Këshillin e Ministrave””.

B A Z A L I G J O R E:

1. Neni 24, 78, 86, 110 si dhe shkronja a), c) dhe ç) të pikës 1 si dhe pika 2 të nenit 119 të ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar (**ligji nr.9918**);
2. Rregullore Nr.20, datë 19.02.2010, mbi “Pagesat për mbikëqyrjen e tregut të komunikimeve elektronike”
3. Udhëzuesi “Për procedurat e Këshillimit Publik” miratuar me Vendim nr. 1183, datë 10.03.2010, të Këshillit Drejtues të AKEP,

4. Vendimi i KD nr. 2493, datë 10.07.2014 “Miratimin e publikimit të raportit të AKEP për Këshillimin Publik, të realizuar për “Kryerjen e studimit mbi pagesat që janë burim financimi në AKEP” dhe propozimeve për miratim në Këshillin e Ministrave””.

K Ë S H I L L I D R E J T U E S:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor, të përbërë nga:

- Projekt Vendimi i Këshillit Drejtues;
- Relacioni shoqërues i Projekt-Vendimit;
- Dokumentin përfundimtar
- Projekt Vendimi për Këshillin e Ministrave
- Anenks “Qëndrimi i AKEP ndaj komenteve të palëve të interesuara”;
- Komentet e palëve të interesuara

si dhe, duke i’u referuar diskutimeve në mbledhje mbi çështjen, bazës ligjore të sipërcituar.

V Ë R E N:

- 1) AKEP me Vendimin nr. 2493 datë 10.07.2014 miratoi nxjerrjen për Këshillim Publik të dokumentit për “Kryerjen e studimit mbi pagesat që janë burim financimi në AKEP” dhe propozimeve për miratim në Këshillin e Ministrave””. Proçedura e këshillimit publik u zhvillua brenda një muaji nga data 24.07.2014 deri më dt.25.08.2014.
- 2) Në përfundim të këshillimit publik në AKEP kanë depozituar komentet palët e interesuara si mëposhtë:
 - a) Vodafone Albania me shkresë Nr.1992 Prot., datë 26.08.2014
 - b) AMC me shkresë Nr. 2049 Prot., datë 04.09.2014
 - c) Albtelecom me shkresë Nr. 2030 Prot., datë 03.09.2014
 - d) Plus Communication me shkesë Nr. 1997 Prot., datë 25.08.2014
 - e) Abcom me shkresë Nr. 1993 Prot., datë 26.08.2014
- 3) Grupi i Punës i ngritur me Urdhërin Nr.1147 dhe Urdhërin Nr. 1147/1, datë 09.05.2014 ka hartuar dokumentacionin e mëposhtëm:
 - Dokument për “Kryerjen e studimit mbi pagesat që janë burim financimi në AKEP” dhe propozimeve për miratim në Këshillin e Ministrave”
 - Aneks “Qëndrimi i AKEP ndaj komenteve të palëve të interesuara”.
- 4) Grupi i Punës në hartimin e dokumentit ka marrë në konsideratë:
 - VKM nr. 599, datë 23.07.2010, i ndryshuar;
 - Rregullore Nr.20, datë 19.02.2010;
 - Burimet e nevojshme financiare të AKEP;
 - Të dhëna të publikuara nga Cullen International;
 - Komentet e palëve të interesuara të depozituara në përfundim të këshillimit publik.

P Ë R K Ë T O A R S Y E:

Këshilli Drejtues i AKEP në zbatim të kuadrit ligjor të cituar më sipër, është njohur dhe ka vlerësuar kontributin e vjelë prej palëve të interesit për dokumentin për “Kryerjen e studimit mbi pagesat që janë burim financimi në AKEP” si dhe ka shqyrtuar propozimet konkrete të grupit të

punës për mbajtjen e një qëndrimi të drejtë dhe transparent mbi këto komente në mënyrë që dokumenti final ti shërbejë qëllimit të nxjerrjes së tij dhe të shërbejë për një propozim të arsyetuar në Këshillin e Ministrave për të ndërmarrë iniciativë ligjore për disa ndryshime në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 599, datë 23.07.2010, i ndryshuar, “ Mbi miratimin e pagesave që kryhen në AKEP, për caktimin dhe përdorimin e frekuencave, të numrave dhe serive numerike”.

Aneksi i hartuar nga Grupi i Punës si “Qëndrimi i AKEP ndaj komenteve të palëve të interesuara” për propozim në organin drejtues të AKEP, reflekton qëndrimin parimor dhe ligjor të AKEP bazuar në dispozitat materiale të Ligjit nr.9918/2008, i ndryshuar.

Këshilli Drejtues, në zbatim të pikës 2 të nenit 119 të ligjit nr.9918, i ndryshuar, datë 19.05.2008,

V E N D O S I:

1. Të miratojë dokumentat :

- a) për “Kryerjen e studimit mbi pagesat që janë burim financimi në AKEP” dhe propozimeve për miratim në Këshillin e Ministrave”
- b) “Qëndrimi i AKEP ndaj komenteve të palëve të interesuara”, sipas dokumentit bashkëngjitur në Aneks :

2. Të propozojë për miratim në Këshillin e Ministrave projektvendimin dhe relacionin përkatës për “Disa ndryshime në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 599, datë 23.07.2010, i ndryshuar, “ Mbi miratimin e pagesave që kryhen në AKEP, për caktimin dhe përdorimin e frekuencave, të numrave dhe serive numerike”

3. Ky Vendim dhe dokumentat e miratuara në pikën 1 të publikohen në faqen e internetit të AKEP: <http://www.akep.al>.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë me miratimin e tij;

K R Y E T A R I

Piro XHIXHO

ANËTARËT E KËSHILLIT DREJTUES:

1. Alban KARAPICI
2. Alketa MUKAVELATI
3. Benon PALOKA
4. Zamira NURÇE



AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE

Studimi mbi pagesat që janë burim financimi të AKEP

Dokumenti përfundimtar

Shtator 2014

(Miratuar me VKD nr. 2500, datë 22.09.2014)

Në lidhje me pagesat që kryhen në AKEP gërmat a), c) dhe ç) të nenit 119 të ligjit nr. 9918, përcaktojnë se sipërmarrësit duhet të kryejnë pagesat në AKEP :

- c) për mbikqyrjen e tregut të komunikimeve elektronike, sipas përcaktimeve në nenin 24 të këtij ligji;
- c) për caktimin dhe përdorimin e frekuencave
- ç) për caktimin dhe përdorimin e numrave dhe të serive numerike.

Në bazë të nenit 24 të Ligjit, sipërmarrësit që ofrojnë rrjete dhe/ose shërbime publike të komunikimit, paguajnë një pagesë vjetore për mbikqyrjen e tregut të komunikimeve elektronike për AKEP.

Pagesat për mbikqyrjen e tregut të Komunikimeve Elektronike, janë aplikuar për operatorët e komunikimeve elektronike (rrjeti dhe/ose shërbime publike) në vitet 2013 dhe 2014, i cili është rreth 0.1% e të ardhurave vjetore të operatorëve të komunikimeve elektronike deri në 0.5 % e përcaktuar në nenin 24 të Ligjit sepse, të ardhurat e buxhetit janë plotësuar kryesisht nga pagesat për caktimin dhe përdorimin e frekuencave, caktimin dhe përdorimin e numrave dhe të serive numerike dhe pagesa të tjera.

Pagesat që kryen në AKEP për caktimin dhe përdorim e frekuencave, për shërbimet e ndryshme radio, janë përcaktuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 599, datë 23.07.2010, i ndryshuar (VKM Nr.911, datë 19.12.2012) *“Për miratimin e pagesave që kryhen në AKEP për caktimin dhe përdorimin e frekuencave, të numrave dhe të serive numerike”*.

Duke u nisur nga eksperiencia e dy viteve të fundit mbi të ardhurat vjetore të sipërmarrësve të komunikimeve elektronike, mbi manaxhimin e spektrit të frekuencave, të cilën e karakterizon dinamika e lartë e ndryshimeve dhe inovacionit të teknologjisë së komunikimeve elektronike, vlerësojmë se pagesa për mbikqyrjen e tregut të komunikimeve elektronike duhet rritur dhe pagesat për përdorim frekuencash si pas përcaktimeve në VKM nr. 599 i ndryshuar, duhen ndryshuar me qëllim që të nxisin një mjedis më të favorshëm, jo diskriminues me synimin e përafrimit të pagesave me koston administrative për administrimin e radiofrekuencave.

Për të krijuar një raport sa më të drejtë për pagesat që bëjnë sipërmarrësit janë hartuar treguesit financiarë të AKEP, për vitet 2014-2015 e në vazhdim , dhe janë mbështetur në:

- Nevoja për shpenzime për vitin 2015 e në vazhdim dhe,
- Pagesat për Mbikqyrjen e Tregut.
- Pagesat për Përdorimin e Frekuencave
- Pagesat për caktimin dhe përdorimin e numrave dhe të serive numerike
- Pagesat për licensimin e operatorëve postarë
- Pagesa dhe të ardhura të tjera,

Shpenzimet dhe pagesat e programuara për vitet 2014 – 2015 e në vazhdim janë në tabelën e mëposhtme:

Në lekë

Nr. Ren	Emërtimi	Viti 2014	Viti 2015
I.	Shpenzimet gjithsej :	259,500,000.00	310,000,000
II.	Pagesat gjithsej :	259,500,000.00	310,000,000
	Nga këto:		
1	Pagesa nga mbikëqyrja e tregut	54,000,000.00	160,000,000
2	Pagesa nga frekuencat	168,900,000.00	116,798,800
3	Pagesa nga numeracioni	25,600,000.00	25,600,000
4	Nga licensimi i operatorëve postarë	300,000.00	300,000
5	Pagesa nga Domain	9,500,000.00	6,300,000
6	Interesa bankare e të tjera	1,200,000.00	1,001,200

Llogaritjet e të ardhurave nga pagesat për Mbikqyrjen e Tregut të komunikimeve elektronike janë bazuar në nenin 24 të ligjit 9918 dhe Rregullores nr. 20, miratuar me Vendim Nr.1170, datë 19.02.2010 të KD të AKEP, dhe në treguesit ekonomik e finaciare, që kanë raportuar operatorët në AKEP, ndërsa pagesat nga caktimi dhe përdorimi i frekuencave të numrave dhe serive numerike janë përcaktuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 599, datë 23.07.2010, i ndryshuar me VKM Nr.911 datë 19.12.2012 “Për miratimin e pagesave që kryhen në AKEP për caktimin dhe përdorimin e frekuencave, të numrave dhe të serive numerike”.

Për vitin 2015 e në vazhdim pagesat nga mbikqyrja e tregut të komunikimeve elektronike, i propozojmë me rritje në krahasim me vitin 2014.

Pagesat e mbikqyrjes së tregut të komunikimeve elektronike në vitin 2014 zenë 20.8% në totalin e pagesave dhe për vitin 2015 pagesat e mbikqyrjes së tregut të komunikimeve elektronike i propozojmë të zenë rreth 51.6% të totalit të pagesave.

Pagesat për caktim dhe përdorim frekuencash i propozojmë me ulje në krahasim me vitin 2014.

Pagesat për caktim dhe përdorim frekuencash në vitin 2014 zenë rreth 65% në totalin e pagesave dhe për vitin 2015 pagesat për caktim dhe përdorim frekuencash i propozojmë të zenë rreth 37.6 % ndaj totalit të pagesave.

Në propozimin me ulje të pagesave për caktim dhe përdorim të frekuencave në vitin 2015 është konsideruar dhe përputhshmëria e pagesave me koston administrative vjetore për administrimin e radiofrekuencave.

Pagesat për caktim dhe përdorim numeracioni propozojmë të mos ndryshohen, sepse janë të balancuar me koston administrative vjetore për administrimin e numeracionit.

Koeficienti i llogaritjes së pagesës për Mbikqyrjen e Tregut në vitin 2015 e në vazhdim e propozojmë me rritje në krahasim me vitet e mëparshme, por është më i vogël se ai që është përcaktuar në nenin 24 të ligjit 9918 dhe Rregullores nr. 20.

Llogaritja e të ardhurave nga pagesat për Mbikqyrjen e Tregut, si dhe koeficienti përkatës paraqiten në tabelën më poshtë:

Në lekë

Nr. Ren	Emërtimi	Viti 2014	Viti 2015
1	Të ardhurat e sipërmarrësve të komunikimeve elektronike	49,870,000,000	49,900,000,000
2	Koeficienti i mbikëqyrjes së tregut të komunikimeve elektronike	0,001083	0,003207
3	Pagesa nga mbikëqyrja e tregut të komunikimeve elektronike	54,000,000	160,000,000

Koeficienti i llogaritjes së pagesës së mbikëqyrjes të komunikimeve elektronike për vitin 2015 e propozojmë rreth 0,3207% të të ardhurave vjetore të sipërmarrësve të komunikimeve elektronike, e cila është më e ulët se kufiri i përcaktuar në nenin 24 të ligjit nr.9918 që është deri në 0.5%.

Pagesa vjetore për caktim dhe përdorim frekuencash janë paraqitur sipas tabelës së më poshtëme:

Në lekë

Nr. Ren	Emërtimi	Viti 2014	Viti 2015
I	Pagesa nga frekuencat gjithsej	168,900,000	116,798,800
	Nga këto:		
1	Pagesa frekuencash nga operatorë publikë	150,683,000	100,471,800
2	Pagesa frekuencash nga operatorë alternativë	4,700,000	2,810,000
3	Pagesa nga frekuencat e PMR	11,675,000	11,675,000
4	Pagesa nga frekuencat për anije	245,000	245,000
5	Pagesa nga frekuencat për avion	20,000	20,000
6	Pagesa nga frekuencat radio – tele vizive	667,000	667,000
7	Pagesa nga frekuencat satelitore	910,000	910,000

Pagesat e paraqitura në tabelë për caktimin dhe përdorimin e frekuencave janë sipas përcaktimeve në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 599, datë 23.07.2010, i ndryshuar me VKM Nr. 911, datë 19.12.2012 “Për miratimin e pagesave që kryhen në AKEP për caktimin dhe përdorimin e frekuencave, të numrave dhe të serive numerike”.

Siç është theksuar dhe më lart, pagesat për caktimin dhe përdorimin e frekuencave për vitin 2015 propozojmë të jenë me ulje 52,101,200 lekë ose rreth 30.9 % në krahasim me vitin 2014. Ulja e pagesave për caktimin dhe përdorimin e frekuencave propozojmë të jenë kryesisht në frekuencat e operatorëve të komunikimeve elektronike (operatorët publikë dhe operatorët

alternativë) pasi pagesat e mbikqyrjes së tregut të komunikimeve elektronike paguhen nga këto operatorë.

AKEP, bazuar në programin e shpenzimeve dhe pagesave për vitin 2015 e në vazhdim, në propozimin për rritjen e pagesave nga mbikqyrja e tregut të komunikimeve elektronike, si dhe për një shpërndarje më të drejtë të pagesave që bëjnë sipërmarrësit për plotësimin e buxheti të AKEP, arriti në përfundimin se duhet të ndryshohen pagesat për caktimin dhe përdorimin e frekuencave në krahasim me ato të VKM Nr. 599, datë 23.07.2010, i ndryshuar me VKM Nr. 911, datë 19.12.2012.

Propozimet për ndryshimet në nivelin e pagesave, për përdorimin e frekuencave për shërbimet radio, në të njëjtën renditje si dhe VKM. Nr.599 datë 23.07.2010, i ndryshuar me VKM Nr. 911, datë 19.12.2012, paraqiten si më poshtë vijon:

I. Lidhjet fikse radio.

Në këto shërbime propozohet zvogëlimi i pagesave i përcaktuar sipas VKM. Nr.599 datë 23.07.2010, i ndryshuar me VKM Nr. 911, datë 19.12.2012, për përdorimin e frekuencave radio, për lidhjet fikse, duke zvogëluar koeficientët përkatës apo vlerën në lekë të njësisë së tij. Propozimi për zvogëlimin e nivelit të pagesës për çdo lidhje radio është në tabelën e mëposhtme:

Sipas VKM 911, date 19.12.2012					PROPOZIMI					Ndryshimi ne % (zbritje)			
Pagesat ne 000/leke					Pagesat ne 000/leke								
Brezi	Gjeresi kanalit radio MHz				Brezi	Gjeresi kanalit radio MHz				Gjeresi kanalit radio MHz			
GHz	≤ 3.5	÷ 20	÷ 40	> 40	GHz	≤ 3.5	÷ 20	÷ 40	> 40	≤ 3.5	÷ 20	÷ 40	> 40
≤ 1	30	-	-	-	≤ 1	18	-	-	-	40.0	-	-	40.0
1 ÷ 14	40	50	55	75	1 ÷ 14	24	30	33		40.0	40.0	40.0	40.0
14 ÷ 20	35	45	50	65	14 ÷ 20	21	27	30	39	40.0	40.0	40.0	40.0
20 ÷ 37	28	35	45	50	20 ÷ 37	16.8	21	27	30	40.0	40.0	40.0	40.0
37 ÷ 39.5	20	30	35	45	37 ÷ 39.5	12	18	21	27	40.0	40.0	40.0	40.0
> 39.5	8	10	12	15	> 39.5	4.8	6	7.2	9	40.0	40.0	40.0	40.0

Propozimet sipas tabelës së mësipërme për lidhje radio ndikojnë në zvogëlimin e të ardhurave financiare në lidhjet fikse për operatorët e komunikimeve elektronike në nivelin 35 - 40 %.

Ndikimi në pagesat e operatorëve të komunikimeve elektronike nga propozimi për zvogëlim të koeficientëve të pagesave lidhjet fikse radio paraqitet në tabelën e mëposhtme:

SUBJEKTI	Nr.Link	VKM 599, i ndryshuar	PROPOZIMI	Ndyshimi në %
ALBTELECOM SHA	508	23,270,000	15,912,000	31.7
AMC	882	38,880,000	26,709,000	31.3
PLUS COMMUNICATION	371	17,235,000	11,394,000	33.9

VODAFONE ALBANIA	846	36,998,000	25,876,800	30.1
OPERATOR Alternativë		4,700,000	2,810,000	40.2
NË TOTAL		121,083,000	82,701,800	31.7

Zvogëlimi i koeficientëve të pagesave për lidhje radio fikse që propozohet, ndikon në zvogëlimin e pagesave në shumën rreth 38,381,200 lekë ose 31.7%.

2. Brezi i Frekuencave GSM/ UMTS.

Në këto shërbime propozohet zvogëlimi i pagesave i përcaktuar sipas VKM. Nr.599 datë 23.07.2010, i ndryshuar me VKM Nr. 911, datë 19.12.2012, për përdorimin e frekuencave GSM/UMTS, duke zvogëluar pagesën në lekë për kanal.

Për përdorimin e frekuencave GSM / UMTS propozohet zvogëlimi i pagesës për kanal rreth 40%.

Propozimi për zvogëlimin e nivelit të pagesës për kanal është në tabelën e mëposhtme:

Brezat e frekuencave	Kanali	VKM 599,i ndryshuar Vlera	Propozimi	
			Propozimi	Ndryshimi %
(450-470)	(2*5) MHz	2,500,000	1,500,000	40
(790-880)	(2*5) MHz	2,300,000	1,400,000	39.1
(880-915) / (925-960)	(2*200) kHz	70,000	42,000	40
(1710-1785) / (1805-1880)	(2*200) kHz	70,000	42,000	40
(1920-1980) / (2110-2170)	(2*5) MHz	1,400,000	840,000	40
(1900-1920) / (2010-2025)	(1*5) MHz	700,000	420,000	40
(2500-2570) / (2620-2690)	(2*5) MHz	1,200,000	720,000	40
(2570-2620)	(1*5) MHz	600,000	360,000	40
(3400-3600) / (3600-3800)	(2*5) MHz	1,000,000	600,000	40

Ndikimi në pagesat nga propozimi për zvogëlimin e pagesave për brezin e frekuencave GSM/ UMTS , paraqitet në tabelën e mëposhtme:

VKM 599,i ndryshuar					Propozimi		Ndryshimi
Brezat e frekuencave	Kanali	Sasi	Vlera	Shuma	Vlera	Shuma	%
450-470 MHz	(2*5)MHz		2,500,000		1,500,000		
790-880 MHz	(2*5)MHz		2,300,000		1,400,000		
GSM/UMTS 900 (880-915)/(925-960)MHz	(2*200) kHz	160	70,000	11,200,000	42,000	6,720,000	40
GSM/UMTS 1800 (1710-1785)/(1805-1880) MHz	(2*200) kHz	180	70,000	12,600,000	42,000	7,560,000	40
UMTS (1920-1980)/(2110-2170)	(2*5)MHz	2*3	1,400,000	8,400,000	840,000	5,040,000	40
UMTS (1900-1920); (2010-2025)	(1*5) MHz	3	700,000	2,100,000	420,000	1,260,000	40
(2500-2690) [(2500-2570)/(2620-2690)	(2*5)MHz		1,200,000		720,000		
2570-2620	(1*5) MHz		600,000		360,000		
(3400-3600)/(3600-3800)MHz	(2*5)MHz		1,000,000		600,000		
SHUMA			0	34,300,000	0	20,580,000	40

Zvogëlimi i pagesës për kanal të brezit të frekuencave të GSM / UMTS ndikon në zvogëlimin e pagesave në shumën 13,720,000 lekë ose 40%.

Nga studimi i pagesave që kryhet për financimin e buxhetit të AKEP, mendojmë se krijohet një raport më i drejtë i pagesave që kryhen për mbikqyerjen e tregut të komunikimeve elektronike me pagesat për caktim dhe përdorim të frekuencave dhe pagesave për numeracion. Në studimin që paraqitet janë të përpëthur kostot administrative të administrimit të brezave të frekuencave me pagesën që kryhet për caktim dhe përdorim të frekuencave që propozohen.

Krahas studimit të pagesave që kryhen në AKEP u analizuan dhe të ardhurat e tepërta mbi shpenzimet që kalojnë në buxhetin e shtetit e cila bazohet në pikën 4, nenin 117 të Ligjit Nr.9918, datë 19.05.2008 “ Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, në të cilin përcaktohet: “Të gjitha të ardhurat e tepërta mbi shpenzimet e Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare kalojnë në Buxhetin e Shtetit”.

Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare, çdo vit të ardhurat e tepërta që realizon, nga pagesat për mbikqyerjen e tregut të komunikimeve elektronike, nga pagesat për përdorimin e frekuencave, nga pagesat për caktimin dhe përdorimin e numrave dhe të serive numerike, nga

pagesat për licensimin e operatorëve postarë dhe nga pagesat e tjera, mbi shpenzimet vjetore, i kalon në buxhetin e shtetit.

Teprica e të ardhurave që mbeten nga shpenzimet në fund të vitit financiar, propozojmë të mbahen në llogari të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare, të përfshihen në programin e financimit të shpenzimeve të vitit pasardhës dhe të mbahen parasysh në llogaritjet dhe faturimet e pagesave që u bëhet sipërmarrësve të komunikimeve elektronike se:

- 1- Është në koheren me Direktivat e Parlamentit dhe Këshillit Europian “*DIRECTIVE 2002/21/EC OF THE EUROPEAN PARLIAMENT AND OF THE COUNCIL of 7 March 2002 on a common regulatory framework for electronic communications networks and services*” neni 11 “***National regulatory authorities should be in possession of all the necessary resources, in terms of staffing, expertise, and financial means, for the performance of their tasks***”, e amenduar me Direktiven “*DIRECTIVE 2009/140/EC OF THE EUROPEAN PARLIAMENT AND OF THE COUNCIL of 25 November 2009 amending Directives 2002/21/EC on a common regulatory framework for electronic communications networks and services, 2002/19/EC on access to, and interconnection of, electronic communications networks and associated facilities, and 2002/20/EC on the authorisation of electronic communications networks and services*. Neni 13, i cili e ka theksuar më shumë në krahasim me direktivën e mëparshme çështjen e pavarësisë së buxhetit. “*It is important that national regulatory authorities responsible for ex-ante market regulation should have their own budget allowing them, in particular, to recruit a sufficient number of qualified staff. In order to ensure transparency, this budget should be published annually*”.
- 2- Krijon mundësi që Autoritetit i Komunikimeve Elektronike dhe Postare të ketë burime financiare për financimin e shpenzimeve në fillim të vitit, deri në arkëtimin e pagesave për mbikqyerjen e tregut të komunikimeve elektronike, për caktim dhe përdorim frekuencash, për caktim të numrave dhe serive numerike. Llogaritja dhe arkëtimi i pagesave nga mbikqyerja e tregut të komunikimeve kryhet pas muajit Maj të çdo vitit, pas dorëzimit të bilancit nga sipërmarrësit dhe miratimit të nivelit të pagesës së mbikqyerjes së tregut të komunikimeve elektronike në Këshillin Drejtues. Llogaritja e pagesave për përdorim dhe caktim frekuencash dhe përdorim dhe caktim numeracioni kryhet gjatë tremujorit të parë të vitit dhe arkëtimi i tyre fillon rreth muajit Mars dhe vazhdon gjatë vitit.
- 3- Krijon mundësinë e uljes së pagesave të sipërmarrësve për Autoritetin e Komunikimeve Elektronike dhe Postare për vitin pasardhës në shumën e tepricës së të ardhurave që mbahet në llogarinë e AKEP-it. Në vitin pasardhës niveli i pagesës së mbikqyerjes së tregut të komunikimeve elektronike (raporti i shpenzimeve vjetore me të ardhurat vjetore të sipërmarrësve) dhe pagesat nga mbikqyerja e tregut të komunikimeve, të ulet në raport me tepricën e të ardhurave të fundit të vitit që janë në llogari të AKEP-it.

- 4- Është në analogji me Ligjin Nr. 97/2013, datë 04.03.2013, “ Për mediat Audiovizive në Republikën e Shqipërisë “, neni 25 “ Caktimi i pagesave”, pika 4 “ Çdo tepricë nga të ardhurat nga pagesat, që mbetet nga shpenzimet përkatëse funksionale AMA-s, në përfundim të vitit financiar, mbahen në llogaritë e AMA-s, përfshihet në planin e shpenzimeve të vitit pasardhës dhe mbahet parasysht në rishikimin e pagesave përkatëse vjetore për licencë”.

Për sa më sipër, AKEP propozon të ndryshohet pika 4, neni 117 të Ligjit Nr. 9918 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”:

Nga: “Të gjitha të ardhurat e tepërta mbi shpenzimet e Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare të kalojnë në Buxhetin e Shtetit”.

Të bëhet : “Të gjithë të ardhurat e tepërta që mbeten nga financimi i shpenzimeve në fund të vitit financiar të mbahen në llogarinë e Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare, të përfshihen në programin e financimit të shpenzimeve të vitit pasardhës dhe të mbahen parasysht në llogaritjen e pagesave që bëhen nga sipërmarrësit e komunikimeve elektronike.

ANEKS



AUTORITETI KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE

QËNDRIMI I AKEP PËR KOMENTET E OPERATORËVE MBI
DOKUMENTIN:

PËR KRYERJEN E STUDIMIT MBI PAGESAT QË JANË BURIM FINANCIMI
NË AKEP

AKEP me VKD Nr.2493, datë 10.07. 2014 miratoi publikim e dokumentit “Miratimin e publikimit të raportit të AKEP për Këshillimin Publik, të realizuar për “Kryerjen e studimit mbi pagesat që janë burim financimi në AKEP” dhe propozimeve për miratim në Këshillin e Ministrave.

Në këtë dokument të publikuar në faqen zyrtare www.akep.al, AKEP kishte hartuar disa pyetje për të marrë opinionin e palëve të interesuara.

Në përfundim të fazës së këshillimit publik në AKEP depozituan komentet operatorët: Vodafone Albania, AMC, Albtelecom, Plus Communication dhe Abcom. Edhe njëherë AKEP i falenderon operatorët për komentet.

Ky dokument përmban komentet e bëra me shkrim nga palët e interesuara dhe qëndrimin e AKEP mbi komentet.

Për orientim dokumenti është stukturuar në këtë mënyrë:

- pyetjet e hartuar nga AKEP në këshillim publik ;
- komentet/parimet e secilit operator mbi këto pyetje, si dhe
- qëndrimin e mbajtur nga AKEP për komentet përkatëse

1. A jeni dakort të rritet pagesa për mbikqyrjen e tregut dhe të ulen pagesat për caktim dhe përdorim të radiofrekuencave?

Përgjigje e Vodafone Albania

VA vlerëson faktin që AKEP ka vendosur të ndërhyjë për të mbledhur të ardhura nëpërmjet tarifës për mbikqyrje tregu me kusht që të mbulojë shpenzimet administrative të tij, ashtu sic edhe neni 24 i Ligjit 9918 parashikon. Në këtë kuptim VA shprehet dakord në parim që nëse është e nevojshme për të mbuluar shpenzimet administrative të AKEP për mbikqyrjen e tregut atëherë të ardhurat duhet të mblihen nëpërmjet pagesës përkatëse të rishikuar sipas nenit 24 të Ligjit 9918 dhe jo nëpërmjet pagesës për caktim dhe përdorim frekuencash apo tarifës për shërbime telekomunikacioni. Sidoqoftë e gjujkojmë të pajustificuar, jo proporcionale dhe jo objektive rritjen me 3 herë të tarifës për mbikqyrjen e tregut.

Përgjigje e AMC

Propozimi bere nga AKEP per rritjen e nivelit te pageses nga 0.1% ne 0.32% eshte i pajustificuar dhe arbitrar, ne shkelje te nenit 7 “Llogaritja e nivelit te pageses vjetore” te Rregullores Nr.20, date 19.02.2010 mbi “Pagesat per mbikqyrjen e tregut te komunikimeve elektronike”, ne te cilin , ne lidhje me llogaritjen e nivelit te pageses citohet si me poshte:

“..... *Niveli i pagesës vjetore për mbikqyrjen e tregut të komunikimeve elektronike do të jetë brenda kufirit prej 0.5% të së ardhurës vjetore te sipërmarrësve, dhe llogaritet me formulën:*

$$\text{NPV} = \frac{\text{KAdV}}{\text{AV}} \times 100$$

NPV - *Niveli i pagesës vjetore të mbikqyrjes të tregut të komunikimeve elektronike (ne%)*

KAdV - *Kosto administrative vjetore e AKEP, që do të financohet nga pagesat për mbikqyrjen e tregut të komunikimeve elektronike.*

AV - *Shuma e të ardhurave vjetore të sipërmarrjeve që ofrojnë rrjete dhe/ose shërbime publike për komunikime elektronike të paraqitura në bilancin vjetor.*”

Ne kete propozim te AKEP, percaktimi nivelit te pageses nga 0.1% ne 0.32% nuk eshte i bazuar ne asnje lloj perlllogaritje se si eshte arritur ne nje vlere te tille, dhe mbi cilat te dhena eshte mbeshtetur AKEP qe ka dale ne nje konkluzion te tille. Neni 7 i Rregullores me siper e percakton shume qarte menyren dhe formulen e llogaritjes se nivelit te pageses vjetore per mbikqyrjen e tregut te komunikimeve elektronike, bazuar ne raportin midis kosos administrative vjetore te AKEP dhe shumes se te ardhurave vjetore te operatoreve te rrjeteve/sherbimeve te komunikimeve elektronike.

Ne propozimin e bere nga AKEP per rritjen e nivelit te pageses se mbikqyrjes se tregut, nuk ka asnje reference, shifra apo informacion tjetër për menyren se si eshte arritur ne vleren 0.32%. Per vitin 2014 e ne vazhdim, ashtu sic citohet ne faqjen 2 te dokumentit per konsultim nuk ka asnje tregues financiar te AKEP te publikuar per justifikimin e rritjes se nivelit te pageses nga operoret per mbikqyrjen e tregut per te mbuluar kostot administrative ne lidhje me kete veprimtari.

Gjithashtu, dhe ne piken 6 te nenit 24 “Pagesat për mbikëqyrjen e tregut të komunikimeve elektronike” te ligjit 9918 i ndryshuar citohet se:

“6. Para miratimit të rregullores, sipas përcaktimeve në pikën 4 të këtij neni, AKEP-i duhet të njoftojë me shkrim sipërmarrësit, për të paraqitur mendimet dhe propozimet e tyre, me shkrim, për pagesën vjetore, mënyrën e përlllogaritjes dhe të zbatimit të saj. Afati i dërgimit të propozimeve nga sipërmarrësit është 30 ditë nga data e marrjes së njoftimit. Mosdërgimi i mendimeve dhe propozimeve brenda këtij afati, nuk përbën pengesë për AKEP-in që të veprojë sipas pikës 4 të këtij neni.”

Pra, neni 24/6 shpreh qartesisht se operoret paraqesin mendimet e tyre per pagesen vjetore dhe per menyren se si kjo pageese eshte perlllogaritur, gje e cila nuk eshte kryer nga ana e e AKEP ne kete dokument, dhe per rrjedhoje eshte ne kundërshtim me piken 6 te nenit nr.24 te ligjit 9918 i ndryshuar.

Ky propozim eshte arbitrar dhe jo transparent ne percaktimin per rritjen e nivelit te pageses per mbikqyrjen e tregut, gje e cila ka dhe nje impakt financiar tek operoret perkatese qe kryejne kete pageese ne llogarine perkatese te AKEP, sepse rrit kostot e tyre

Pra edhe pse ulen tarifat per frekuencat me synimin per te mbulur me to kostot administrative per

monitorimin e tyre, ndryshimi i formules per pagesat per mbikqyerjen e tregut, pervecse mbulon kete ulje te tarifave per frekuencat, krijon te ardhur shtese per AKEP pa asnje arsye, duhe renduar buxhetin e AMC

Prandaj, per sa shprehur dhe me siper, AMC eshte kunder propozimit te AKEP per rritjen e nivelit te pageses se mbikqyrjes se tregut te komunikimeve elektronike, duke qene ne kundërshtim me percaktimet e nenit 7 te Rregullores per pagesat per mbikqyrjen e tregut si dhe me nenin 24 pika 6 te Ligjit 9918, dhe ky propozim eshte i pajustificuar dhe arbitrar pasi AKEP nuk ka dhene dhe asnje reference se si e ka percaktuar rritjen e vleres ne 0.32%, dhe nuk ka publikuar asnje tregues statistikor per vitin 2014 per justifikimin e nivelit te propozuar te pageses per mbulimin e kostove perkatese administrative te AKEP ne lidhje me mbikqyrjen e tregut.

Megjithate duhet te themi se AKEP ne kete dokument nuk ka specifikuar se ku eshte bazuar ne percaktimin e nivelit te ketyre pagesave. Duke qene se ato jane te lidhura ngushte me shpenzimet administrative per monitorimin dhe menaxhimin e frekuencave, eshte i domosdoshem publikimi i ketyre shpenzimeve ne harkun kohor te nje viti, ne menyre qe ndryshimi i ketyre pagesave te jete: a) e justifikueshme b) sa me transparente.

Publikimi i shpenzimeve administrative per kete qellim eshte nje kerkese qe percaktohet qarte dhe ne direktivat e BE-se (Neni 12/2, Direktiva e Autorizimit 2002/20): Article 12/Administrative charges “2. Where national regulatory authorities impose administrative charges, they shall publish a yearly overview of their administrative costs and of the total sum of the charges collected. In the light of the difference between the total sum of the charges and the administrative costs, appropriate adjustments shall be made.”

Publikimi i shpenzimeve te AKEP eshte gjithashtu nje detyrim ligjor, sic percaktohet ne nenin 117 dhe 119 te ligjit nr.9918 per komunikimet elektronike i ndryshuar.

Ne baze te nenit 119 te ligjit per komunikimet elektronike pika 3 dhe 4 si me poshte:

3. Përcaktimi i pagesave për caktimin dhe përdorimin e frekuencave e të numrave bëhet në bazë të parimit të proporcionalitetit, transparencës dhe objektivitetit, duke minimizuar shpenzimet administrative shtesë dhe taksat shtesë. Në veçanti:

a) të ardhurat totale vjetore nga pagesat e përcaktuara në shkronjat “c” dhe “ç” të pikës 1 të këtij neni duhet të përputhen me koston administrative vjetore të AKEP-it për administrimin e radiofrekuencave dhe numrave;

b) Ndryshimi i pagesave për breza të ndryshëm të frekuencave ose për kategoritë e ndryshme të numrave duhet të përputhet me ndryshimin në koston administrative për administrimin e këtyre brezave dhe kategoritë e ndryshme të numrave.

4. AKEP-i, në zbatim të parimit të transparencës, çdo vit publikon, në faqen e tij zyrtare, një përmbledhje të situatës financiare, duke dhënë kostot administrative/shpenzimet dhe të ardhurat totale të krijuara respektivisht nga pagesat për mbikëqyrjen e tregut, pagesat për numeracionin dhe ato për frekuencat. AKEP-i, gjithashtu, publikon bilancin financiar vjetor që depoziton në organet tatimore, në përputhje me legjislacionin në fuqi për këtë qellim.

Ndersa ne lidhje me pagesat per caktimin dhe perdorimin e frekuencave AMC eshte dakort ne parim me propozimin e AKEP per uljen e ketyre pagesave.

Edhe pse AMC shprehet dakort me propozimin per uljen e pagesave vjetore per frekuencat GSM dhe UMTS, per sa i perket nivelit te uljes se tyre nuk mund jape nje vleresim sa me te sakte, pasi nuk ka nje baze per t'u mbeshtetur ne vleresimin e saj ne lidhje me keto pagesa.

Prandaj eshte e domosdoshme dhe imediate, duke qene nje detyrim, qe AKEP te specifikojte ne detaje shpenzimet vjetore per administrimin e frekuencave ne menyre qe te kihet nje panorame me e qarte dhe transparente ne lidhje me nivelin e propozuar te pagesave, te cilat duhet te mbeshteten ne kostot reale te AKEP-it per menaxhimin e ketyre frekuencave.

Shpenzimet administrative te AKEP per kete qellim duhet te reflektohen ne pagesat vjetore qe

behen nga operatorët perkates qe kane ne perdorim frekuencat GSM dhe UMTS, ne menyre qe te jene proporcionale me administrimin dhe menaxhimin e tyre.

Përgjigje e Albtelecom

Albtelecom përshëndet dhe mirëpret iniciativën e AKEP në lidhje me uljen e pagesave për caktimin dhe përdorimin e frekuencave si për lidhjet fikse radio ashtu edhe për brezin e frekuencave GSM/UMTS. Albtelecom vlerëson maksimalisht synimin e AKEP për caktimin e pagesave për radiofrekuencat në mënyrë që këto të jenë objektivist të jsutifikuara, jo-diskriminuese, propocionale, të nxisin konkurrencën dhe përdorimin efikas si dhe që të përputhen me koston administrative vjetore të AKEP për administrimin e spektrit dhe numeracionit.

Por ndërkohë, Albtelecom nuk mund të shprehet dakort me përcaktimin në parim se pagesa për mbikqyrjen e tregut duhet të rritet. Albtelecom mirëkupton se me ndryshimin e pagesave për lidhjet fikse dhe frekuencat, edhe pagesa për mbikqyrjen e tregut do të mund të pësojë ndryshime për mbulimin e kostove administrative të AKEP, por nuk mund të paravendoset që në dokument se kjo pagesë do të rritet dhe për më tepër në vlera të përcaktuara. Pagesa e mbikqyrjes së tregut është qartësisht e parashikuar në Ligjin nr. 9918, i ndryshuar , neni 24, pika 4 sipas të cilit “Niveli i pagesës vjetore për mbikëqyrjen e tregut të komunikimeve elektronike, brenda kufirit prej 0,5 për qind të së ardhurës vjetore, përcaktohet në rregulloren e AKEP-it, të nxjerrë në përputhje me këtë ligj.”

Në këtë kuadër, AKEP me Vendim nr. 1170 dt. 19.02.2010 ka miratuar Rregulloren mbi Pagesat për Mbikqyrjen e Tregut të Komunikimeve Elektronike, qëllimi i të cilës është përcaktimi i pagesës vjetore për mbikqyrjen e tregut të komunikimeve elektronike që duhet të kryejnë sipërmarrësit brënda kufirit prej 0.5% të së ardhurës vjetore.

Në vijim, në nenin 7 të kësaj Rregulloreje përcaktohet qartë se deri më datë 15 Prill të çdo viti bën llogaritjen e nivelit të pagesës vjetore për mbikqyrjen e tregut të komunikimeve elektronike të sipërmarrësve që ofrojnë rrjete dhe/ose shërbime publike të komunikimeve elektronike. Kështu, në përputhje me këtë Rregullore, me Vendim nr. 2487 dt. 26.06.2014 AKEP ka miratuar nivelin e pagesës së mbikqyrjes së tregut për vitin 2014 në vlerën e 0.112834% të ardhurës vjetore të sipërmarrësve të komunikimeve elektronike të vitit 2013, për financimin e koston administrative të vitit 2014.

Në këtë kontekst, dokumenti i pagesave që propozohet të miratohet me Vendim të Këshilli i Ministrave nuk mund të paracakttojë rritjen e kësaj pagese, për më tepër vlerën fikse të saj. Llogaritja e nivelit të pagesës se mbikqyrjes duhet të ndjekë procedurat e përcaktuara në Ligj dhe Rregulloren përkatëse. Neni 7 i Rregullores përcakton qartë se niveli i kësaj pagese është i ndryshueshëm vit pas viti dhe mënyrën e llogaritjes me formulën:

$$NPV = (KAdv / AV) * 100$$

ku, KAdv është Kosto Administrative vjetore e AKEP, që financohet nga pagesat për mbikqyrjen e tregut dhe AV është shuma e të ardhurave vjetore të sipërmarrësve të tregut të komunikimeve elektronike.

Referuar formulës së mësipërme, shuma e koston administrative që do të mbulohet nga pagesat për mbikqyrjen e tregut, KAdv mund edhe të rritet si rrjedhojë e propozimit për ulje të pagesave për përdorimin e frekuencave dhe pagesave për lidhjet fikse radio (varësisht shpenzimeve të buxhetuara nga AKEP për vitet në vazhdim, të cilat do të duhej të ishin transparente dhe bashkëngjitur në këtë dokument)

Ndërkohë, Niveli i pagesës vjetore (NPV) mund të rritet në rast të rritjes së shumës së koston

administrative KAdv (kur të ardhurat e sipërmarrësve janë afërsisht në nivelet aktuale), ose mund të ulet në rast të rritjes së të ardhurave të sipërmarrësve në Tregun e Komunikimeve Elektronike në një vit të caktuar (AV). Rrjedhimisht, niveli i pagesës vjetore (NPV) ose koeficienti i pagesës së mbikqyrjes së tregut i zbatuar për vitin 2014, ~0.1%, në asnjë rast nuk mund të paracaktohet dhe nuk mund të jetë fiks/i pandryshueshëm për çdo vit.

Paracaktimi i këtij koeficienti në mënyrë të shprehur dhe miratimi i tij me Vendim të Këshillit të Ministrave në vlerën prej 0.32%, nuk është i justifikuar objektivisht, për disa arsye të renditura si më poshtë:

- nëse shpenzimet administrative për vitet 2013 e 2014 janë mbuluar kryesisht nga pagesat për caktimin dhe përdorimin e frekuencave, përdorimin e numrave dhe serive numerike, etj (përmendur në dokument), me uljen e pagesave për këto zëra automatikisht/rrjedhimisht do të ndryshojë shumën e kostos administrative në formulën për llogaritjen e koeficientit të pagesës së mbikqyrjes;

- ndryshimi i shumës së kostos administrative në formulë (KAdv), edhe në rast të parashikimeve shumë të sakta mbi shpenzimet e AKEP për vitin 2015 e në vazhdim, nuk mund të çojë në përcaktim të saktë të nivelit/koeficientit të pagesës vjetore të mbikqyrjes (NPV) sa kohë që të ardhurat e sipërmarrësve në Tregun e Komunikimeve Elektronike (AV) ndikohen nga shumë faktorë dhe variojnë në vite, varësisht performancës së kompanive dhe kërkesës për shërbime telefonike në treg;

- për më tepër, nëse synohet që teprica e të ardhurave të mbahet në llogari të AKEP dhe të përfshihet në financimin e shpenzimeve të vitit pasardhës, duke i zbritur në llogaritjet dhe faturimet e pagesave të sipërmarrësve të komunikimeve elektronike, është praktikisht e pamundur përcaktimi apo vendosja e një koeficienti fiks lidhur me pagesat për mbikqyrjen e tregut.

Gjithashtu, theksojmë se si rezultat i ndryshimeve të propozuara në dokument mbi pagesat e mbikqyrjes së tregut, të lidhjeve fikse dhe përdorimit të radiofrekuencave, bazuar në të ardhurat e Altelecom për vitin 2013, pagesa neto vjetore e Altelecom rritet me 27%, ose në vlerë absolute me 12,712,051 LEK.

Në përfundim, Altelecom konsideron jo të drejtë dhe nuk është dakort me përcaktimin/paracaktimin e rritjes së nivelit/koeficientit të Pagesës Vjetore të mbikqyrjes (NPV) dhe paracaktimit të vlerës së tij në masën 0.32%.

Përgjigje e Plus Communication

PLUS shprehet dakord me uljen në vlerën 40% të pagesave për përdorim frekuencash me qëllim nxitjen e një mjedisi më të favorshëm, jo diskriminues e më konkurrues në tregun e komunikimeve elektronike, përdorimin efikas, sigurimin e menaxhimit efektiv të përdorimit të frekuencave me synimin e përafrimit të pagesave me koston administrative për administrimin e radiofrekuencave.

PLUS gjykon se edhe pagesa për lidhje radio duhet të ulet gjithashtu në të njëjtin nivel (40%), pasi lidhjet radio kanë një peshë shumë të madhe në pagesat e operatorëve për AKEP, rreth 55% të pagesës totale vjetore.

Në lidhje me pagesën për mbikqyrjen e tregut të komunikimeve elektronike, PLUS shprehet dakord për rritjen e kësaj vlere për të kompensuar uljet nga pagesat për caktim dhe përdorim të radiofrekuencave me qëllim promovimin e konkurrencës efektive në treg mes operatorëve si dhe parimit të proporcionalitetit e mosdiskriminimit.

Në këtë këndvështrim, për të mbrojtur operatorët më të vegjël, në situatën ku aktualisht ndodhet

tregu i komunikimeve elektronike në Shqipëri, në referencë edhe të Analizës të Tregut të Telefonisë së Lëvizshme për vitin 2013, PLUS propozon përcaktimin e pagesës për mbikqyrjen e tregut në një nga alternativat e mëposhtme:

Alternativa 1. Paga të jetë e diferencuar në dy nivele:

- operatorët me pjesë tregu në të ardhura më pak se 10% të të ardhurave totale të komunikimeve elektronike, të përjashtohen nga kjo pagesë;
- operatorët me pjesë tregu në të ardhura mbi 10% të të ardhurave totale të komunikimeve elektronike, të paguajnë vlerën e përcaktuar për pagesën për mbikqyrjen e tregut, në një përqindje të të ardhurave vjetore sipas përcaktimeve ligjore.

Alternativa 2. PLUS sugjeron ndryshimin e legjislacionit dhe kuadrit rregullator përkatës sipas të cilit: Paga vjetore për mbikqyrjen e tregut nuk duhet të jetë më shumë se 0,5 përqind e fitimit neto të vitit kalendarik të mëparshëm dhe jo të ardhurës vjetore.

PLUS gjykon se përzgjedhja e një prej alternativave të mësipërme për përlogaritjen e pagesës për mbikqyrjen e tregut do të garantojë në mënyrë më efektive qëllimin e këtij dokumenti për realizimin faktik të konkurrencës në tregun e komunikimeve elektronike, mosdiskriminimit të operatorëve të vegjël në treg dhe vendosjes së barrës fiskale në bazë të parimit të proporcionalitetit sipas rezultateve financiare të operatorëve.

Përgjigje e Abcom

Kjo pyetje perben edhe thelbin e ketij diskutimi publik dhe eshte e lidhur ngushte edhe me arsyjen pse eshte ndermarre kjo iniciative.

Perdorimi i frekuencave per operatorët e rrjeteve fikse te komunikimeve elektornike ka nje tendence ne rnie. AKEP ka konstatuar qe mjedisi ne zona te caktuara eshte mjaft i ndotur nga keneshtirmi i perdorimit te ferkuencave dhe per kete qellim AKEP ne perputhje me strategjine e zhvillimit te sektorit po perpiqet qe te orientoje operatoet drejt largimit nga perdormi i frekuencave.

Per kete qellim kane sherbyer disa masa lehtesuaese ne ofrimin e mundesive alternative te transmetimit sic jane ndertimi i rrjeteve me fiber optike etj.

Konstatimit qew veprimi i propozuar nga AKEP per uljen e tarifave per perdorimin e frekuencave ne kete studim, shkon ne drejtim te kunder me poliriken e perdorimit efikas te resourceve te fundme sic ajne edhe frekunecat.

Konkuluzion: Ne nuk jemi dakort me rritjen e e detyrimit per mbikqyrjen e tregut. Kjo demton ne vecanti operatorët alternative ku shumica e tyre nuk perdorin frekuenca per rrjete e tyre. Ne kushte shume te veshtira te biznesit te OA kjo do te ishte nje barre e paperballueshme per ta.

Qëndrimi i AKEP

Në këtë pikë AKEP sqaron VA se pavarësisht formulimit në pyetjen 1“rritje” nuk bëhet fjalë për rritje nga norma e përcaktuar në ligj.

AKEP sqaron Plus Communication se objekti i këtij studimi janë pagesat që kryhen në AKEP brenda normave dhe mundësive që na lejon ligj Nr.9918, datë 19.5.2008, i ndryshuar, për të qënë sa më proporcionale dhe jodiskriminues, për të financuar kostot administrative.

Gjithashtu AKEP sqaron Abcom se arsyeja e sipër përmendur është edhe inicimi i këtij procesi. AKEP sqaron operatorët se NPV(niveli i pagesës vjetore të mbikqyrjes së tregut) i propozuar është bërë mbi bazën e kostove administrative vjetore të AKEP që do të financohen nga pagesat për mbikqyrjen e tregut dhe mbi bazën e shumës së të ardhurave vjetore nga shërbimet e komunikimeve elektronike të paraqitura në pasqyrat financiare të vitit paraardhës dhe nuk është një NPR përfundimtar. Me këtë NPV të propozuar AKEP u lejon operatorët të parashikojnë buxhetin e tyre për pagesat ndaj AKEP, më me saktësi për vitin në vijim.

Përsa i takon komentit të operatorit AMC për nenin 24/6 të ligjit 9918, i ndryshuar, AKEP sqaron se përpara se të miratohej rregullorja 20 dt.19.02.2010, palëve të interesuara iu është

kërkuar të shprehin mendimi dhe të paraqesin porpozimin e tyre. Në monentim e miratimit operatorët kanë qënë të gjithë dakort, sepse ky process ishte vijim i punës së AKEP për mosdiskrimin dhe proporcionalitet ndaj operatorëve. Përsa i takon publikimit të shpenzimeve sipas ligjit 9918, i ndryshuar, raporti vjetor është bërë publik për të gjithë palët e interesuara, në faqen zyrtare të AKEP.

2. A jeni dakort të ruhet e njëjta strukturë e tabelës së mësipërme lidhur me ndarjen e brezave te frekuencave radio per llogaritjet e pagesave ?

Përgjigje e AMC

AMC eshte dakort qe te ruhet e njejta strukture lidhur me ndarjen e brezave te frekuencave radio per llogaritjet e pagesave.

Përgjigje e Albtelecom

Me propozimet e reja për pagesa nga AKEP, ulja në pagesa është e ndjeshme dhe ne jemi dakort me këtë propozim, por ekziston mundësia që duke bere një ndarje në më shumë grupe sipas grupeve tëfrekuencave dhe standarteve ITU, ETSI që përdoren për gjërësinë e kanaleve me radio linqe dhe që mund te arrihet një optimizim i mëtejshem i bandave të frekuencave dhe rrjedhimisht i pagesave.

Tabela e mëposhtme paraqet strukturën që ALBtelecom propozon për ndarjen e bandës së frekuencave për pagesat:

Band (GHz)	Channel Bandëidth (MHz)				
	<=7	<=14	<=30	<=40	>=56
<=6					
<=7					
<=11					
<=13					
<=15					
<=18					
<=23					
<=38<					

Përgjigje e Plus Communication

PLUS është dakord që të ruhet e njëjta strukturë lidhur me ndarjen e brezave te frekuencave radio dhe llogaritjet e pagesave për këto breza.

Përgjigje e Abcom

Jemi dakord me stuktuten e tabelës per ndarjen e frekuencave e cila eshte bazuar ne planin kombetar te frekuencave.

Qëndrimi i AKEP

VA nuk ka komentuar për këtë pike. AMC. Plus dhe Abcom janë dakort me propozimin e AKEP.

Ndarjen e kanaleve AKEP e ka bërë në përputhje me PKF dhe PPF, ku janë implementuar Rekomandimet dhe Vendimet CEPT.

3. Cili është mendimi Juaj për vlerat e pagesave të propozuara?

Përgjigje e Vodafone Albania

VA e gjykon të pajustificuar, jo proporcionale dhe jo objektive rritjen me 3 herë të tarifës për mbikqyrjen e tregut. Ne kemi bërë një përlllogaritje të përafërt mbi bazën e skemës së propozuar dhe rezulton se një rritje e propozuar në nivelin 3.2% të pagesës për mbikqyrjen e tregut e marrë së bashku me uljet për pagesat e shfrytëzimit të frekuencave rezulton në marzhe negative për VA dhe detyrim të shtuar prej të paktën 30 milionë Lekësh apo një rritje prej 142% .

Efekti financiar i ndryshimeve të pagesave propozuar nga AKEP

Tabela: Efekti financiar i ndryshimeve të pagesave propozuar nga AKEP

Në këto kushte, jo vetëm që inisiativa e propozuar nuk lehtëson barrën e pagesave ndaj operatorëve, sic në fakt duhet të ndodhë (duke ju referuar taksimit të dyfishtë dhe rënies konstante të të ardhurave nga tregu i komunikimeve elektronike), por përkundrazi; propozimi i AKEP rrit në mënyrë drastike detyrimet e operatorëve duke cënuar seriozisht frymëmarrjen e bizneseve dhe duke penguar investimet e mundshme.

Mbi të gjitha rritja e të ardhurave që synon të mbledhë AKEP në këtë nivel është e pajustificuar, për aq sa kemi mundësi të vëzhgojmë dhe analizojmë, në mungesë të transparencës financiare. Konkretisht,

- Rezulton nga Raportet vjetorë të AKEP 2011-2013 se niveli i shpenzimeve të planifikuara (por jo të realizuar nga AKEP) ka qenë 330 milion Lekë në vitin 2011; 266 milion Lekë në vitin 2012; dhe 273 milion Lekë në vitin 2013- pra qartësisht në zbritje. Për këtë arsye është plotësisht e pajustificuar se përse duhet rritur barra e pagesave për shpenzimet e AKEP ndërkohë që ato vijnë në zbritje, sic edhe janë në zbritje të vazhdueshme të ardhurat e operatorëve. Nga ana tjetër nuk ekziston asnjë zhvillim i tregut në vitin e fundit që të justifikojë një rritje shpenzimesh të këtij niveli.

- Gjithashtu rezulton nga Raporti vjetor për vitin 2013 publikuar në faqen zyrtare të AKEP se “Teprica e të ardhurave në fund të vitit 2013 rezulton në shumën 85,794,617 lekë e cila është përfituar si rezultat i tejkalimit të të ardhurave në shumën 6,266,368 lekë dhe mos realizimi i shpenzimeve në shumën 79,528,249 lekë.” (faqe 71 e Raportit). Me fjalë të tjera buxheti i AKEP pavarësisht mos realizimit të shpenzimeve ka pasur teprica.

- Po e njëjta situatë haset në Raportin vjetor për vitin 2012 ku theksohet se “Teprica e të ardhurave në fund të vitit 2012 rezulton në shumën 119,494,449 Lekë, e cila është përfituar si rezultat i tejkalimit të të ardhurave në shumën 23,251,403 Lekë dhe mosrealizimi i shpenzimeve në shumën 96,243,046 Lekë (faqe 54 e Raportit). Sërish buxheti i AKEP pavarësisht mosrealizimit të shpenzimeve të parashikuara ka pasur teprica që më pas janë derdhur në buxhetin e shtetit.

- Pra është evidente që AKEP rradhazi në vite ka tepricë buxheti edhe për pagesat që mbledh në nivelet aktuale, pa marrë fare në konsideratë rritjen e propozuar e cila do të rrisë edhe më tej tepricat, cka e bën tërësisht jo proporcional dhe jo-objektiv e të justifikuar propozimin në fjalë.

- Vlen për tu theksuar se përjashtojmë rastet kur për arsye objektive fondi në buxhet nuk është shpenzuar, në disa raste të tjera për shkak të efikasitetit në rritje, zërat e shpenzimeve kanë qenë në ulje krahasuar me buxhetin e planifikuar. Kjo përbën një arsye më shumë që nxjerr në pah jo-përshtatshmërinë e rritjes drastike të shumës së kërkuar nga AKEP për mbikqyrje tregu (shiko Raportet Vjetore të AKEP 2011 në fq. 30; 2012 në fq. 51-56 dhe 2013 në fq. 66-71).

- Më tej, rezulton se në rolin e agjentit tatimor (sipas taksimit të dyfishtë nëpërmjet Udhëzimit të përbashkët të Ministrisë së Financave dhe AKEP, Nr. 28) AKEP ka përfituar për

vitin 2011 një shumë prej 14,580,120 lekësh e cila ka shkuar e gjitha për shpërblime punonjësish. E njëjta situatë haset dhe në vitin 2012, ku është mbledhur një shumë prej 16,322,728 Lekë, dhe 16,320,468 Lekë nga e cila është shpenzuar në formën e shpërblimeve për punonjësit e AKEP (faqe 55, Raporti Vjetor 2012). Ndërkohë që për vitin 2013 në realizimin e detyrës si agjent tatimor AKEP ka përfituar komisione në masën 5 % të shumës së derdhur në Buxhetin e Shtetit në shumën 15,174,254 lekë, por pa sqaruar se çfarë është bërë me këtë shumë të ardhurash (faqe 71, Raporti vjetor 2013).

Në këto kushte nëse AKEP deri më sot, sic edhe shprehet, ka shfrytëzuar të ardhurat e mbledhura nga pagesat për spektrin për të financuar koston administrative të mbikqyrjes së tregut, atëherë maksimalisht (apo në rastin më të keq) ajo cka duhet të korrigjojë është që shumën e të ardhurave që janë marrë nga pagesat e spektrit të mbledhë këtej e tutje nëpërmjet pagesës së mbikqyrjes së tregut, por kurrësi nuk duhet të shumëfishojë në mënyrë plotësisht të paarsyeshme dhe arbitrare pagesat në tërësi sic propozohet në draft aktin për shqyrtim.

VA sugjeron që për të qenë më reale kjo pagesë për mbikqyrjen e tregut duhet të aplikohet mbi EBIT (Earnings Before Interest and Tax) e operatorëve dhe jo mbi vlerën totale të të ardhurave, të cilat nuk pasqyrojnë saktësisht përfitimin e operatorëve në treg.

Përgjigje e AMC

AMC është dakort për uljen e pagesave të propozuara nga AKEP përkatësisht për lidhjet fikse radio (në nivelin 35% - 40%) dhe për brezin e frekuencave GSM/UMTS (në nivelin rreth 40% për kanal), duke çuar në uljen e kostove financiare për operatorët e komunikimeve elektronike.

AMC është kundër me propozimin për pagesën e mbikqyrjes së tregut duke u bazuar në koeficientin prej 0.32 të përcaktuar në mënyrë arbitrare, pa konsideruar kostot administrative të mbikqyrjes së tregut nga AKEP dhe të ardhurat e tregut të komunikimeve elektronike të vendit, në mënyrë që të kjo të shpendahet në mënyrë proporcionale tek të gjithë operatorët që operojnë në këtë treg.

Përgjigje e Albtelecom

Albtelecom përshëndet iniciativën e AKEP për reduktimin e pagesave aktuale me 30%-40% nga pagesat aktuale për lidhjet fikse dhe frekuencat në GSM/UMTS. Albtelecom sheh këtë qasje të AKEP në përputhje me objekt

ivat e përaktuara nga Ligji për përcaktimin e pagesave të sipërmarrësve dhe në përputhje me Kuadrin Rregullator European për komunikimet elektronike sipas të cilit pagesat e sipërmarrësve përcaktohen në nivele të tilla që të mund të mbulojnë vetëm kostot administrative të Oraganit Rregullator.

Në të njëjtën kohë Albtelecom shpreh rezervat e tij në lidhje me propozimin për rritjen e pagesave për mbikqyrjen e tregut dhe paracaktimit të vlerës së tij në vlerë fikse. Shqetësimi i Albtelecom në lidhje me vlerën e pagesës për mbikqyrjen është trajtuar gjërësisht në Pyetjen 1 më sipër.

Përgjigje e Plus Communication

Në përputhje me përgjigjen e dhënë në Pyetjen 1 të këtij dokumenti, PLUS shpreh dakortësinë e tij për ndryshimin e pagesave që janë burim financimi në AKEP dhe uljen e pagesave për caktimin dhe përdorimin e radio frekuencave për të nxitur një mjedis më të favorshëm e jodiskriminues në tregun e komunikimeve elektronike.

Ndërsa pagesa për mbikqyrjen e tregut e cila bazohet në të ardhurat e operatorëve, gjykojmë se duhet të bazohet në fitimet neto të tyre, parë situatën në treg, ku operatorët e mëdhenj kanë një fuqi mjaft të lartë financiare krahasuar me operatorët e vegjël, referuar Analizës së Tregut të Telefonisë të Lëvizshme për vitin 2013, ku pjesa e operatorëve të mëdhenj përbën rreth 85% e të

ardhurave totale në tregun e telefonisë së lëvizshme .

Përgjigje e Abcom

Propozimet e bera per pagesat jane me efekte te ndryshme per operatore te ndryshem. Ujla e detyrimit per frekuencat e lehteson operatorin qe i perdorin me shume. Rritja e detyrimit per mbikqyrjen e tregut edhe me lart ngarkon operatorin e rrjete fikse dhe sidomos OA e vegjel.

Nga nje perllogaritej qe kemi bere per detyrimet e nje OA qe perdor frekuenca rezulton qe detyrimi ne total ka nje rritje rreth 12% krahasuar me detyrimin e meparshem.

Konkuzion: nuk jemi dakort me rritjen e detyrimit per mbikqyrjen e tregut

Qëndrimi i AKEP

Ndryshimi i peshes që zënë këto pagesa në burimet e financimit të AKEP, ka qëllim të mbullojë shpenzimet administrative siç i përcakton dhe ligji 9918, i ndryshuar. Studimi është bërë edhe duke marrë parasysh praktikat e vendeve të rajonit, ku shumica e vendeve me të cilat mund të krahasohemi kanë burimin kryesor financimn pagesat për mbikqyrja. Këtë e tregon dhe tabela e mëposhtme për fondet e financimit të rregullatore rajonale për vitin 2012.




Figure.1 – NRA funding sources in 2012¹

Për këtë arsye ato nuk mund të ulen më shume se sa janë paraqitur në Dokumentin e Këshillimit Publik. AKEP sqaron VA se shifrat e tabelës së paraqitur në komentin 3 nuk janë përcaktuar qartë se për cilat vite flitet dhe për pagesa të VA apo në nivel sektori të komunikimeve elektronike në Shqipëri, kur është e qartë që këtë vit shuma e arkëtuar në nivel kombëtare nga pagesa për mbikqyrje tregu ishte rreth 54 milion, kurse aktualisht VA e pasqyron ndryshe. Duke u nisur nga sa shpjeguar mësipër AKEP nuk mund të gjykoje dot për marzhet e komentuar nga VA.

Për sa i përket se kush duhet të merret në konsideratë si bazë për llogaritjen e pagesës së mbikqyrjes së tregut, ligji 8819, neni 24, pika 4, e ka të përcaktuar “...Niveli i pagesës vjetore për mbikqyrjen e tregut të komunikimeve elektronike, brenda kufirit prej 0,5 për qind të së ardhurës vjetore..” dhe rregullorja Nr. 20 datë 19.02.2010, neni 5 “...është pagesë e plotë vjetore dhe llogaritet mbi të ardhurat nga ofrimi i rrjeteve dhe/ose shërbime publike të komunikimeve elektronike te paraqitura në bilancin vjetor të sipërmarrjes...”

Persa i takon planit të shpenzimeve, AKEP për 2015 ka parashikuar fond më të madh se në vitet paraardhës, duke qënë se ka planifikuar ngritjen e një qendre kombetare të monitorimit, ndaj dhe buxheti i parashikuar për 2015 e në vazhdim vjen me rritje. Pavarësisht rritjes së

¹ Burim Cullen Internacional

NPV të parashikuar sic edhe jemi shpjeguar më sipër, ai është brenda normave të lejuara nga ligji dhe i përcaktuar mbi baza të argumentuara.

Për komentet e bëra nga Abcom, AKEP nuk është dakort me komentin “*ka nje rritje rreth 12% krahasuar me vitet e meparshme...*”. Për të vërtetuar një efekt të tillë duhen paraqitur të dhena krahasuese më të plota dhe të shtrina në kohë, në mënyrë që efekti i ndryshimit të jetë bindës.

4. Cili është mendimi Juaj për tepricën e të ardhurave të AKEP në fund të vitit?

Përgjigje e Vodafone Albania

VA shprehet dakord që tepricat e të ardhurave të mbledhura nga operatorët nuk duhet të kalojnë në buxhetin e shtetit, pasi ato të ardhura janë mbledhur për një qëllim të caktuar dhe si të tilla nuk mund të ‘shpronësohen’ në mënyrë të paligjshme. Ligji 9918 parashikon qartë se të ardhurat e mbledhura shkojnë për mbikqyrjen e tregut dhe për caktimin dhe përdorimin e spektrit dhe numeracionit, ndaj tepricat ose duhet ti kthehen operatorëve ose duhet të përcillen në buxhetin e vitit të ardhshëm të AKEP dhe ky i fundit duhet ti zbrësë nga të ardhurat e përlllogaritura për vitin e ardhshëm për atë operator.

Përgjigje e AMC

AKEP duhet të parashikojë me peripikmeri buxhetin dhe kostot administrative të tij. Dhe mbi bazën e këtij buxheti + kostot administrative, rregullores për pagesat për mbikqyerjen e tregut AKEP nuk duhet të krijojë teprica të konsiderueshme të të ardhurave të tij për të mos krijuar pagesa nga ana e operatorëve të cilat do të rezultojnë si teprica tek AKEP dhe ndërkohe rëndojnë/dëmtojnë buxhetet e operatorëve pa asnjë shkak kur këto shuma le të themi të mund të përdoren për investime të metejshme nga ana e operatorëve

Përgjigje e Albtelecom

Lidhur me tepricën e të ardhurave që mbeten nga shpenzimet e pakryera në fund të një viti financiar, Albtelecom shpreh dakortësinë e tij për të mbetur në llogari të AKEP.

Albtelecom shpreh këtë qëndrim në mbështetje të mundësisë që, në mënyrë transparente, këto teprica të mund të ri-investohen për projekte të ndryshme që do mund të shërbejnë në të mirën/benefitet e sipërmarrësve të komunikimeve elektronike në funksion të kryerjes së detyrave dhe objektivave të AKEP në lidhje me mirëadministrimin e spektrit të frekuencave apo edhe në funksion të mbikqyrjes më efektive të tregut.

Përgjigje e Plus Communication

PLUS shpreh mendimin që teprica e të ardhurave që mbeten nga shpenzimet në fund të vitit financiar të mbahen në llogari të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare, për tu përfshirë në programin e financimit të shpenzimeve që do të kryhen nga operatorët vitin pasardhës.

Përgjigje e Abcom

Duke qene se pagesat qe kryhen ne AKEP jane burime financini ne AKEP dhe po ashtu duke konsideruar qe shpenzimet ne AKEP jane te mireplanizuaran ekziston mundesia qe edhe pagesat per miukqyrje te jene parashikuar sakte dhe si rezultat nuk do te kishte vend per diferenca te medha midis planit dhe realizimit. Per rrjedhoje mund te themi qe per diferencat e vogla qe mund te rezultojne ne fund te viti ushtimor, tepricat te perdoren ne fondet e sherbimit universal.

Qëndrimi i AKEP

4 nga operatore kane argumentuar qarte pse teprica duhet te mos derdhet ne buxhet dhe ndajne te njejten qendrim me AKEP.

AKEP sqaron operatorin AMC se nga praktikat e çdo njësie ekonomike ose institucioni nuk përputhen programimi i shpenzimeve me realizimin faktit në një vit ushtimor, përndryshe nuk do të ishte e nevojshme të evidentohen shpenzimet faktike.

5. A jeni dakort që teprica e të ardhurave të AKEP në fund vitit të zbriten në pagesat e sipërmarrësve në vitin pasardhës.

Përgjigje e Vodafone Albania

VA shprehet që teprica e të ardhurave që mbliidhen nga AKEP për mbikqyrjen e tregut dhe caktimin dhe përdorimin e spektrit dhe numeracionit të kakahet në buxhetin e vitit të ardhshëm të AKEP dhe ky i fundit duhet ta zbrësë këtë shumë nga detyrimet e operatorit për vitin e ardhshëm

Përgjigje e AMC

AMC eshte e mendimit qe teprica e te ardhurave nga shpenzimet ne fund te vitit financiar te mbahet ne llogari te AKEP dhe te perfshihet ne programin e financimit te shpenzimeve te viti pasardhes dhe te mbahen parasysh duke i zbritur ne llogaritjet dhe faturime e pagesave qe u behet sipermarrësve te komunikimeve elektronike ne vitin pasardhes.

Megjithate jane disa problematika per tu trajtuar ketu. Se pari kjo bie ndesh me nenin 117 pika 4 ne te cilin thuhet se te gjitha te ardhurat e teperta te AKEP kalojne ne buxhetin e shtetit. Ky lloj propozimi kerkon ndryshimin e ligjit te komunikimeve elektronike.

Problematika tjeter qe duhet trajtuar ketu eshte transparencja. Sic e kemi permendur edhe me lart AKEP duhet te jape nje pasqyre te qarte financiare te kostove administrative sipas nenit 119 pika 4, te parashikuara per vitin pasardhes ashtu edhe realizimin e tyre.

Mbi cformule dhe mbi clogaritje keto teprica do te perfshihen nga programin e e financimit te shpenzimeve te viti pasardhes?

Prandaj kerkojme nga ana e AKEP qe te detajohet menyra se si keto teprica do te perfshihen nga program i financimit te shpenzimeve te viti pasardhes dhe koha ekzakte e veprimeve perkatese

Me tej kjo do te lejoje qe edhe operatoret te parashikojne buxhetet e tyre me sakte si dhe duke i lejuar ara te operojne nga ana financiare pa probleme per parashikime jo te sakta .

Përgjigje e Albtelecom

Albtelecom shpreh dakortësinë e tij lidhur me tepricën e të ardhurave në fund të vitit financiar dhe përfshirjen e tyre në financimin e shpenzimeve të vitit pasardhës, dhe mbajtjen parasysh duke i zbritur në llogaritjet dhe faturimet e pagesave që u bëhen sipërmarrësve, Por, në të njëjtën kohë, për të siguruar korrektësinë dhe transparencën e këtij procesi është e nevojshme:

- Të bëhet evidente teprica e të ardhurave në fund të çdo viti financiar nga AKEP, dhe të sigurohet proporcionaliteti i zbritjes së saj nga faturimet përkatëse për çdo sipërmarrës të Tregut të Komunikimeve Elektronike;

- Të zbritet nga shuma e kostos së shpenzimeve administrative të vitit pasardhës, teprica e të ardhurave dhe mbi këtë bazë të bëhet përcaktimi i koeficientit të pagesës së mbikqyrjes së tregut.

- Pra, të mos përfshihet në relacionin përkatës që do t'i dërgohet Këshillit të Ministrave, paracaktimi i nivelit/koeficientit të pagesës vjetore të mbikqyrjes së tregut 0.32%, por të lihet vetëm përcaktimi aktual siç dhe është në ligjin e telekomunikacioneve, deri në 0.5 % të të ardhurës vjetore të çdo sipërmarrësi. Llogaritja e nivelit të pagesës vjetore të mbikqyrjes së tregut të kryhet sipas përcaktimeve në nenet nr. 7 dhe 8 të Rregullores nr. 20, mbi “Pagesat për mbikqyrjen e Tregut të Komunikimeve Elektronike”.

Përgjigje e Plus Communication

Sic është shprehur edhe në Përgjigjen e Pyetjes 4, Plus kërkon që vlera e teprices të të ardhurave që mbeten nga shpenzimet në fund të vitit , tu bëhet e ditur operatorëve dhe vlera e mbetur dhe e deklaruar, të zbritet nga pagesat e sipërmarrësve në mënyrë proporcionale e në përqindje të barabartë në faturimet e pagesave për çdo operator, në vitin pasues .

Përgjigje e Abcom

Për sa theksohet në këtë pyetje i mbetemi propozimit të bërë në Përgjigjen e pyetjes 4. Nëse për arsye të ndryshme diferencat janë të konsiderueshme, atëherë jemi dakort që tepricat e të ardhurave në AKEP në fund të vitit të zbriten nga pagesat e sipërmarrësve në vitin pasardhës.

Qëndrimi i AKEP

Për këtë pyetje operatorët janë shprehur dakort me propozimin e AKEP që teprica e të ardhurave vjetore të mos derdhet në fund të vitit në buxhetin e shtetit . Ata shprehen dakort me propozimin e AKEP, për kalimin e saj në buxhetin e vitit pasardhës duke iu zbritur operatorëve nga pagesat.